



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

---



**Procesverbali nga Konsultimi publik për Draft-Rregulloren për Tarifa, Ngarkesa dhe  
Gjoha Komunale**

Korrik 2024

Procesverbali nga Konsultimi publik për plotësim ndryshimin e Draft-Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale

Data: 03.07.2024

Ora: 10:00

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

### **PROCESVERBAL**

Komuna e Vushtrisë ka mbajtur konsultim publik me qytetarët, ku është diskutuar për plotësim-ndryshimin e Draft-Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

Të pranishëm kanë qenë anëtarët e komisionit Ilirjana Azemi, Mentor Jashari, Remzije Zekolli dhe Haki Bunjaku.

Ilirjana Azemi, kryesuese e komisionit, para qytetarëve ka prezantuar punën e komisionit për plotësim-ndryshimin e Draft-Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

Paraprakisht tek të gjithë qytetarët pjesëmarrës në diskutim është dorëzuar edhe në formë fizike Draft-Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, në mënyrë që të jenë të informuar.

Më pas, fjala ka kaluar tek qytetarët pjesëmarrës për t'i paraqitur kërkesat e tyre.

**Gëzim Saraçi, përfaqësues i DKRS-së**, theksoi se ka dërguar propozimet edhe përmes emailit, por të njëjtat nuk janë inkorporuar në draft-rregullore. Në Shtëpinë e Kulturës janë bërë investime të mëdha dhe mendoj se edhe tarifat për pagesa janë të arsyeshme.

**Xhavit Mehmeti, nga shoqëria civile**, përgëzoi komisionin për punën e bërë dhe më pas paraqiti kërkesat e tij për draft-rregullore. Ai kërkoi që tek tarifat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, tek sporti në pikën 1.2 për 90 minuta stërvitje për klubet sportive të hiqet pagesa. Tek pika 1.8 pagesa për 60 minuta për rekreacion për aktivitete të lira pagesa nga 12 euro të jetë 6 euro, në mënyrë që të masivizohen aktivitetet sportive. Pastaj tek pika 1.22 tarifat nga reklamat, në palestër sportive kemi reklama statike e cila është vendosur që 2 vite e nuk paguan asgjë, duhet të shikohen edhe njëherë se si të bëhet tarifa për vendosjen e reklamave dhe të njëjtat pagesa të kryhen.

**Arbenita Maloku Muzaqi**, diskutoi rreth tarifave në Drejtorinë e Administratës ku tha se Vërtetimi për Ndërrim të vendbanimit është 5€, ndërsa janë disa kategori të cilat lirohen nga pagesa, por te ky vërtetimi ata paguajnë.

Takimi përfundoi në ora 11:00.

Procesmbajtëse:

Remzije Zekolli

---